



**Znj. Alma Jarani**

## PËRGJEGJËSE E SEKTORIT TË MASËS DHE DENSITETIT

### Profili

Diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UNIVERSITETIT POLITEKNIK të TIRANËS UPT, ka mbrojtur diplomë “Master shkencor” si Inxhinier Mekanik Teknolog (Prodhim-Menaxhim).

Karrierën profesionale znj. Alma (Shtylla) Jarani e ka nisur në fushën e energjisë në Ndërmarrjen Termo Energjitike Tiranë (deri 1994), duke vijuar me një eksperiencë të vlefshme në fushën e statistikës, informatikës, menaxhimit dhe prokurimit të fondeve publike dhe jo vetëm, në Bashkinë e Tiranës, ku ka mbajtur detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Statistikës dhe Informatikës (1997-2001). Falë trajnimeve të vazhdueshme profesionale tekniko-shkencore, menaxheriale dhe prokurimeve publike.

Eksperenca akademike e znj. Alma (Shtylla) Jarani si Anëtare e Stafit Akademik të UPT Tiranë (Pedagoge e jashtme - Lektore) fillon që nga viti akademik 2002-2003 e në vazhdim, një eksperiencë rreth 18-vjeçare, pranë Departamentit të Hidraulikës dhe Hidroteknikës të FIN (Mekanikë fluidesh), Departamentit të Energjitikës të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike FIM (Fizikë teknike, Makina, Makina Hidraulike) dhe Departamentit të Prodhim-Menaxhimit (Menaxhimi i Makinave dhe Sistemeve Energjitike (Edukim në distancë).

Znj. Jarani ka ndjekur Shkollën e Studimeve të Thelluara Pasuniversitare SH.P.U, në Departamentin e Prodhim-Menaxhimit të UPT (2003-2006), ka marrë diplomë “MASTER” të Nivelit të Dytë në “Inxhinieri Mekanike” dhe ka mbrojtur mikrotezën me temë: “Kavitacioni në Turbomakinat dhe mënyrat e parandalimit të saj” (2007). Ka ndjekur shkollën e Doktoraturës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (2010).

Që nga viti 2007 znj. Jarani është staf i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, fillimisht në Sektorin e Masës dhe Njësive që Rrjedhin prej saj dhe që nga viti 2013 e në vazhdim, mban pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Masës dhe Densitetit në Drejtorinë e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Deklarimi i Aftesive Matëse dhe Kalibruese (CMC) në fushën e masës në Bazën e të Dhënave të Ndërkrahimeve Kyçe (KCDB) të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM) në vitin 2013, përmirësimi i tyre në 2015, rideklarimi tyre në 2019 dhe rivlerësimi i tyre së fundmi nëpërmjet Peer Review në 2024, tregon përkushtimin, përgjegjësinë dhe profesionalizmin e znj. Jarani.

Falë kualifikimeve universitare dhe pas universitare tekniko-shkencore dhe menaxheriale, brenda dhe jashtë vendit, eksperiencës në fushën e metrologjisë, znj. Jarani përfaqëson denjësisht Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Shqipërinë në Komitetin Teknik të Masës dhe Njësive që Rrjedhin prej saj (TC-M) në EURAMET. Është Auditore e brendshme për Sistemet e Menaxhimit dhe Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë që nga viti 2010. Vlerësuese/eksperte teknike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit që nga viti 2013. Kryetare e Komisionit për Standartet e hekurudhave në Drejtorinë e Përgjithshme të Standarteve që nga viti 2008. Autore e disa botimeve shkencore, statistikore etj; Udhëheqëse/recensente diplomash “Bachelor” dhe “Master” pranë UPT Tiranë. Trajnuese për të tretë në fushën e metrologjisë /mbikqyrëse e punonjësve të rinj, etj. Njohëse shumë e mirë e gjuhës angleze, në të folur dhe të shkruar si dhe njohëse e mirë e gjuhës italiane.

**[alma.jarani@dpm.gov.al](mailto:alma.jarani@dpm.gov.al)**